



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 18839/25
Kaçanik, 12.08.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VIII (tetë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 12 Gusht 2025 (E martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-I Pavarur, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ. Nga ekzekutivi i komunës, drejtori i Shëndetësisë-Sali Malsiu nuk mori pjesë në mbledhje.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Maviqe Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VIII-të (tetë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, data 12 Gusht, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Gjendja aktuale QKMF-së në Komunën e Kaçanikut;
- 3.Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverballi ?

Procesverballi i mbledhjes se VII-të (shtatë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2025, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverballin e mbledhjes se VII-të (shtatë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2025, të datës 08.07.2025 / Lënda: 01Nr. 60/01- 15343/25.

2. Gjendja aktuale QKMF-së në Komunën e Kaçanikut

z.Ekrem Livoreka: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z.Arben Thaçi : Cili është aktualisht niveli i furnizimit me barna esenciale në institucionet shëndetësore të komunës, dhe si qëndron situata lidhur me procesin e vaksinimit të qytetarëve?

znj.Arta Avdiu: Meqenëse drejtori i Shëndetësisë nuk është i pranishëm, propozoj që kjo çështje të konsiderohet si kërkesë zyrtare për zgjatjen e orareve të punës në laborator, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtë dhe shërbimi të bëhet më efikas.

znj. Lejla Muhaxheri-Çaka: Si janë kushtet higjienike aktuale në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe a ndërmerren masa të rregullta për mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e hapësirave shëndetësore?

z.Ekrem Livoreka: Sa ka qenë fluksi i pacientëve gjatë kësaj periudhe dhe a ka funksionuar orari i barnatoreve sipas planifikimit? Gjithashtu, sa Qendra të Mjekësisë Familjare dhe Ambulanca të Mjekësisë Familjare janë funksionalizuar aktualisht nëpër fshatra?

3.Të ndryshme:

z.Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 11:42.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

